



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Duke u bazuar në Rregulloren Nr. 02/2021/EXD për Procedurën e Rekrutimit dhe Emërimit në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, KPM shpall:

## KONKURS

### Për plotësimin e vendeve të lira të punës

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Lartë për Monitorim Regjional**

**Departamenti: Departamenti i Monitorimit dhe Analizave**

**Numri i pozitave: Tre (3) pozita**

**Paga mujore bruto: 666 € (bruto)**

**Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, pas periudhës provuese**

**Numri i referencës: 2209/803/ADM/n.a**

**Vendi i punës: Prishtinë**

#### Detyrat dhe përgjegjësitë :

1. Mbikëqyrë dhe vlerëson pajtueshmërinë e përmbajtjeve programore të të licencuarave të KPM-së me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së;
2. Mban kontakte të rregullta pune me të licencuarit e KPM-së për të siguruar komunikim efektiv të dyanshëm në mes të KPM-së dhe të licencuarve;
3. Ndihmon në vlerësimin dhe trajtimin e ankesave që pretendojnë shkelje të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së;
4. Kryen inspektive monitoruese në terren, në koordinim me departamentet relevante, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së të licencuarve me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së;
5. Përmes hierarkisë së Zyrës Ekzekutive, njofton të licencuarit me shkrim për çdo pretendim/ankesë apo procedim ligjor lidhur me shkeljet e Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së;
6. Në bashkëpunim me Departamentet tjera këshillon strukturat më të larta hierarkike për politikën, rregulloret dhe akteve tjera përkatëse për Divizionin të cilat duhet të zhvillohen dhe miratohen nga KPM;
7. Ndihmon në propozimin e aktiviteteve të rregullta vjetore dhe periodike që kanë të bëjnë me monitorimin e të licencuarave;
8. Ndihmon në përgatitjen e të gjitha materialeve dhe informatave të nevojshme që lidhen me punën e Divizionit për diskutim në Komision;
9. Kryen punë të tjera relevante që kërkohen nga Drejtori i Departamentit, përmes Udhëheqësit të Divizionit.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

1. Diplomë Universitare në fushën e Gazetarisë; Komunikimit Masiv; Filologjisë; Filozofisë; Marrëdhënie Ndërkombëtare; Drejtësisë dhe Ekonomisë;
2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale të përafërt me natyrën e punës së KPM-së; përvojë punë në institucione publike apo private, ose në ndonjë organizatë ndërkombëtare, me theks në fushën e gazetarisë, komunikimit masiv dhe të kulturës.

**Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:**

1. Njohuri për legjislacionin vendor në fushën e mediave, standardeve ndërkombëtare në fushën e mediave dhe lirisë së shprehjes;
2. Aftësi të mira për hartimin e dokumenteve ligjore, analitike, komunikuese dhe për të punuar në ekip;
3. Aftësi për të punuar brenda afateve të kufizuara kohore;
4. Njohuri për përdorim të kompjuterit për nevojat e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të punës;

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Frekuencave**

**Departamenti: Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave**

**Numri i pozitave: Një (1) pozitë**

**Paga mujore bruto: 666€ (bruto)**

**Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, pas periudhës provuese**

**Numri i referencës: 2209/804/ADM/n.a**

**Vendi i punës: Prishtinë**

**Detyrat dhe përgjegjësitë :**

1. Ndihmon në përgatitjen e planit për ndarjen e frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës;
2. Ndihmon në përcaktimin e frekuencave të radio dhe televizioneve transmetuese të licencuara dhe mirëmban frekuencat si dhe menaxhon me bazën e të dhënave.
3. Kryen inspektime monitoruese të brezit frekuencorë në terren, në koordinim me departamentet relevante, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së të licencuarve me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së;
4. Analizon spektrin e frekuencave të transmetimit për Republikën e Kosovës analog dhe dixhital (radio dhe TV), në pajtim me standardet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit;
5. Ndihmon në menaxhimin e databazës së frekuencave (FM/TV);
6. Pranon ankesat në lidhje me interferencat frekuencore;
7. Përgatit raporte dhe analiza për të gjitha rastet e vetë iniciuara dhe sipas kërkesës;
8. Mban një databazë në baza vjetore për rastet e trajtuara;
9. Ndihmon në përgatitjen e të gjitha materialeve dhe informatave të nevojshme që lidhen me punën e Divizionit për diskutim në Komision;
10. Kryen punë të tjera relevante që kërkohen nga Drejtori i Departamentit, përmes Udhëheqësit të Divizionit.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

1. Diplomë universitare në fushën e telekomunikacionit;
2. Tre (3) vite përvojë pune profesionale të përafërt me natyrën e punës së KPM-së; përvojë punë në institucione publike apo private, ose në ndonjë organizatë ndërkombëtare, me theks të veçant në fushën e transmetimeve radiotelevizive (telekomunikuese).

**Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:**

1. Njohuri elementare me pajisje profesionale për matje dhe analizim të brezit frekuencore FM/TV;
2. Njohuri për rregullat dhe rregulloret e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit dhe standardet Evropiane për transmetim;
3. Aftësi analitike, komunikuese dhe fleksibilitet për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore;
4. Aftësi të avansuara në kompjuter;

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Jetëshkrimi - CV; Letra motivuese; Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopjet e dëshmimeve mbi trajnimet relevante; Kopjet e dëshmisë së punësimit; Dëshmi nga gjykata që nuk ka qenë i dënuar më parë dhe nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj kandidatit si dhe kopja e letërnjoftimit. Në rastet kur diploma është e lëshuar nga një shtet jashtë Kosovës, atëherë duhet të jetë e barasvlershme dhe e njohur me ligjet në Kosovë.

KPM ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

**Afati i konkurrimit është prej datës 20/09/2022 deri më datë 04/10/2022, deri në orën 16:00.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Aplikacionet dorëzohen në Komisionin e Pavarur të Mediave, Rr. Perandori Justinian nr.124. "Qyteza Pejton" 10000 Prishtinë. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë deri në ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në numrin e tel: +383 38 245 031, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KPM-së, në linkun: [www.kpm-ks.org](http://www.kpm-ks.org)